

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI
i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“VIVINO ALBANIA” SH.P.K.**

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” – Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

KAPITULLI I

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Me efekt nga data 24.06.2025 themelohet shoqeria “VIVINO ALBANIA” (ne vijim “Shoqeria”), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “Shpk”, cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.2 Ortaket e Shoqerise (“Ortaket”) gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
 - (i) fjalet “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” ose “shpk”;
 - (ii) numri unik i identifikimit (NUIS) te saj;
 - (iii) adresa e regjistruar, dhe
 - (iv) dhe pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
 - (v) Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise.

Neni 2. Forma dhe Baza Ligjore

- 2.1. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete dokument (Akti i Themelimit dhe Statuti), si dhe legjislacionin shqiptar.
- 2.2 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (“shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”), ne perputhje me ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare (“Ligji i Shoqerive Tregtare”).

Neni 3. Selia



3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, kati 2, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë seline e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4. Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti i Shoqërisë

5.1 Objekti i veprimtarive të Shoqërisë është:

Import-eksport dhe tregëtim me shumicë e pakice të artikujve të ndryshëm, produkteve të industrisë bujqësore ushqimore, produkte të industrive ushqimore, pije, pije alkoolike dhe të distiluara, alkool, verë, verë spumante, shmapanjë, uiski, birra, vermuthe dhe pije të tjera alkoolike dhe jo alkoolike, sider, ujë dhe pije freskuese, pije të gazuara, produkte të konservuara, produkteve energjike, duhan i përpunuar, cigare, puro, cigarillo, cigare elektronike, produkte duhani produkte me bazë fruta dhe perime, fruta të përpunuara dhe konservuara, bërthama dhe bajame, produkte të tjera ushqimore, biskota, produkte çokollate dhe ëmbëlsira sheqeri, çokollatë për konsum, ëmbëlsira të paketuara, shërbime të ndërmjetme në tregëti me shumicë të ushqimeve, pijeve dhe duhanit. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmes, e cila është e dobishme dhe ka për qëllim përmbushjen e objektit kryesor të saj. Shoqëria mund të marrë pjesë në menyrë të drejtperdrejtë ose të terthortë në shoqëri të tjera që kanë për objekt të ngjashëm apo që lidhen me objektin e shoqërisë.

5.2 Nëse veprimtari të tilla kërkojnë aprovim, autorizim, leje ose licencë paraprake të lëshuar nga autoritetet publik, Shoqëria do të marrë cilëndo nga sa më sipër, përpara se të kryejë ndonjë veprimtari të tillë e cila kërkon marrjen e tyre.

Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sik parashikohet në këtë Statut duke marrë parasysh dispozitat e legjislacionit shqiptar.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 7. Kapitali Themeltar



- 7.1. Kapitali i themeltar i Shoqerise eshte ne vleren 100 (njqind Leke), plotesisht te nenshkuara dhe te pashlyera.
- 7.2. Kapitali i Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese, brenda nje periudhe prej 1 viti nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB.
- 7.3. Kapitali i Shoqerise do te perbehet nga 1 (nje) Kuote.

Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

8.1 Ortaku i vetem i Shoqerise dhe kuota e zoteruar prej tij ne Shoqeri eshte si me poshte:

- **NOA HOLDING Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT M31509039J, me seli ne Rr. "Bulevardi Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, kati i 2 Tirane, e cila do te zoteroje nje kuote qe perfaqeson **100 %** te kapitalit te Shoqerise, ne vleren 100 (njqind) Leke.

Neni 9 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 9.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.
- 9.2. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- 9.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
- 9.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 10 Transferimi i kapitalit

- 10.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashegimise;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 10.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 10.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KAPITULLI III



Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

Neni 11

Organi Vendimmarres

- 11.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 11.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 11.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:
- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
 - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.
- 11.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
- 11.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 12.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t’u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 12.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 13

Kuorumi

- 13.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
- 13.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund te marre

vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

13.3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

14.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

14.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

14.3. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

15.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 16

Administrimi

16.1. Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

16.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

16.3. Administrator i shoqerise eshte Znj. Eranda Nepravishta, me banim ne Tirane, me leternjoftim me nr. 038401242.



Neni 17

Kompetencat e Administratoreve

17.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

17.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

17.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

17.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 18

Pergjegjesite e Administratorit

18.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

18.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

18.3. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

18.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoj me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

18.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

18.3.3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

18.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

18.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KAPITULLI IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 19 **Viti Financiar**

19.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20 **Ekspertet**

20.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

20.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.



Prishja –riorganizimi i shoqerise

Neni 21

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

d) me vendim te gjykates;

21.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

21.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 22

9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 23

23.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Nenshkrimi

NOA HOLDING SHPK

Besiana Antoni
Administrator

Adminstrator